



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 333/2 Prot.

Tiranë, më 20.07.2016

V E N D I M
Nr. 83, datë 20.07.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 333 prot., datë 18.04.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes dijeni nga informacioni i dërguar prej Bashkisë Përmet, për disa parregullsi të konstatuara si dhe me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me aktin nr. 333 prot., datë 18.04.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbim civil, në Bashkinë Përmet”, ka filluar kryesisht verifikimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në këtë institucion.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Përmet nga grupi i punës i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Institucioni u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 333/1 prot., datë 18.04.2016 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Bashkia Përmet është organ i qeverisjes vendore i konstituuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale (në rubrikën *Qarku Gjirokastrë, Qyteti Përmet*), të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimeve të ligjit më sipër, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Përmet dhe katër Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë Qendër Piskovë, Petran, Fshatër, dhe Çarçovë (*këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të*).

Bazuar në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Këshilli i Bashkisë Përmet, me aktin administrativ nr. 06, datë 04.03.2016 *“Për Miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative në varësi të saj”*, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Përmet dhe Njësive Administrative nën varësinë e saj, i cili përcaktohet të jetë **294** punonjës.

Vendimi i mësipërm nuk është vënë në zbatim nga ana e institucionit, i cili aktualisht, operon me strukturën transitorë të miratuar me Urdhrin nr. 20, datë 30.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në zbatim të Vendimit nr. 27, datë 03.09.2015, të Këshillit të Bashkisë Përmet, *“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative”*.

Sipas strukturës të mësipërme, në këtë bashki dhe njësitë administrative në përbërje të saj, janë në total **152** pozicione pune, ndër të cilët rreth **35** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga fakti se, në strukturën e institucionit nuk ishin specifikuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe për arsye se, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e institucionit nuk kishte realizuar një analizë për të përcaktuar numrin e pozicioneve të punës pjesë të shërbimit civil, si dhe të faktit që mungonin përshkrimet e punës, ky numër ka dalë duke u bazuar në emërtesën e pozicioneve të punës të përcaktuar në strukturën e bashkisë, kategorinë e pagës, si dhe detyrat që kryejnë realisht punonjësit në këto pozicione.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin nën inspektim, rezultoi se:

- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Bashkisë Përmet, nuk i ka përcaktuar në strukturë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil.
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Bashkisë Përmet, nuk është shprehur për asnjë nga punonjësit ekzistues, në lidhje me statusin e tyre të punësimit, sipas detyrimit që rrjedh prej nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*.
- Të gjitha njësitë e burimeve njerëzore të ish-Komunave, që aktualisht janë Njësi Administrative në varësi të Bashkisë në fjalë, nuk kanë deklaruar statusin e punësimit për punonjësit që punonin në një vend pune pjesë të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

- Njësia përgjegjëse, nuk ka kryer verifikimin e marrëdhënies së punës, për personelin e Njësive Administrative, transferuar pranë saj, sipas rezultateve të të cilit duhej të deklarojë statusin e punësimit në shërbim civil për punonjësit që i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil. Bazuar në germën “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, njësia përgjegjëse e bashkisë, ka marrë funksionet e organit përgjegjës për personelin e ish-Komunave të riorganizuara pranë saj dhe duhet të shprehet në lidhje me statusin e tyre të punësimit për punonjësit, në rast se njësia përgjegjëse e ish-Komunave nuk është shprehur.
- Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Përmet, nuk ka miratuar planin vjetor për pranimin në shërbim civil, për vitin 2016.

Sa më sipër, gjatë inspektimit, u verifikua se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Përmet, ka plotësuar **22 pozicione** pune pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Këto emërimet nuk janë kryer sipas një procedure konkurrimi të hapur, apo lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë, si mënyra të vetme për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Konkretisht bëhet fjalë për pozicionet e punës të paraqitura, më poshtë:

1. *****; emëruar me Vendimin nr. 22, datë 05.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Përgjegjës administrate”;
2. *****; emëruar me Vendimin nr. 78, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist i Trashëgimisë Kulturore”;
3. *****; emëruar me Vendimin nr. 74, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist PAK”;
4. *****; emëruar me Vendimin nr. 58, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist Taksash”;
5. *****; emëruar me Vendimin nr. 45, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist Informacioni, Statistike dhe Media”;
6. *****; emëruar me Vendimin nr. 38, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist Shërbimesh”;
7. *****; emëruar me Vendimin nr. 34, datë 09.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike”;
8. *****; emëruar me Vendimin nr. 121, datë 11.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist Urbanistike”;
9. *****; emëruar me Vendimin nr. 120, datë 08.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Jurist”;
10. *****; emëruar me Vendimin nr. 104, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Specialist Taksash”;
11. *****; emëruar me Vendimin nr. 96, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Juriste”;
12. *****; emëruar me Vendimin nr. 82, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;
13. *****; emëruar me Vendimin nr. 81, datë 21.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;

14. *****; emëruar me Vendimin nr. 78, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialist Finance*”;
15. *****; emëruar me Vendimin nr. 67, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialist Projektesh në Urbanistik*”;
16. *****; emëruar me Vendimin nr. 62, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialist Urbanistike*”;
17. *****; emëruar me Vendimin nr. 60, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës Arsimore*”;
18. *****; emëruar me Vendimin nr. 59, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialiste Muzeu*”;
19. *****; emëruar me Vendimin nr. 42, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialit urbanistike*”;
20. *****; emëruar me Vendimin nr. 34, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialist Shëndetësie*”;
21. *****; emëruar me Vendimin nr. 10 datë 01.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”;
22. *****; emëruar me Vendimin nr. 6, datë 14.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike PAK*”.

Në datën 28 maj 2016 ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili në nenin 185, “*Dispozita kalimtare*”, përcakton se, “*Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar*”, e për këtë arsye këto procedura të nisura, do të vijojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm.

Në këto kushte, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe në nenin 155/a dhe 116/c, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar, aktet administrative për emërimin e **22 punonjësve** në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të pasqyruara më sipër, të dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil, duhet të revokohen, si akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”; e nenin 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

T'i kërkojë njësisë përgjegjëse që për rregullimin e ligjshmërisë, e cila rezulton se nuk është zbatuar nga institucioni, pasi ka kryer emërimet në pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, të menaxhojë në përputhje me ligjin burimet njerëzore të institucionit duke zbatuar detyrat si më poshtë:

1. Të kërkojë nga organi kompetent, të miratojë strukturën përfundimtare, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil, të bashkisë dhe njësisë administrative në varësi të bashkisë, në përputhje me vendimin nr. 06, datë 04.03.2016, të Këshillit të Bashkisë Përmet, *“Për Miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative në varësi të saj”*.
2. Mbas miratimit të strukturës përfundimtare nga Kryetari i Bashkisë Përmet, njësisë përgjegjëse të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, të cilat ushtrojnë funksione publike, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit që do të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Përmet, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur *“Pozicion pune në shërbimin civil”*.
3. Njësia përgjegjëse të kryejë verifikimin e marrëdhënieve të punës së personelit ekzistues të Bashkisë Përmet dhe Njësive Administrative në varësi të saj (*ish-Komunave*), nëse ka raste kur ata kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (*data 26.02.2014*).

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të marrëdhënieve të punës së personelit ekzistues, njësisë përgjegjëse duhet të vijojë me procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

4. Njësia përgjegjëse, të revokojë aktet administrative, të cilët kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të **22 punonjësve**, si më poshtë:

1. Të revokojë aktin administrativ nr. 22, datë 05.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës administrate”;
2. Të revokojë aktin administrativ nr. 78, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist i Trashëgimisë Kulturore”;
3. Të revokojë aktin administrativ nr. 74, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist PAK”;
4. Të revokojë aktin administrativ nr. 58, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Taksash”;
5. Të revokojë aktin administrativ nr. 45, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Informacioni, Statistike dhe Media”;
6. Të revokojë aktin administrativ nr. 38, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Shërbimesh”;
7. Të revokojë aktin administrativ nr. 34, datë 09.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike”;
8. Të revokojë aktin administrativ nr. 121, datë 11.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Urbanistike”;
9. Të revokojë aktin administrativ nr. 120, datë 08.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Jurist”;
10. Të revokojë aktin administrativ nr. 104, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Taksash”;
11. Të revokojë aktin administrativ nr. 96, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Juriste”;
12. Të revokojë aktin administrativ nr. 82, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;
13. Të revokojë aktin administrativ nr. 81, datë 21.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;
14. Të revokojë aktin administrativ nr. 78, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Finance”;
15. Të revokojë aktin administrativ nr. 67, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Projektesh në Urbanistik”;
16. Të revokojë aktin administrativ nr. 62, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Urbanistike”;
17. Të revokojë aktin administrativ nr. 60, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës Zyrës Arsimore”;
18. Të revokojë aktin administrativ nr. 59, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialiste Muzeu”;
19. Të revokojë aktin administrativ nr. 42, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialit urbanistike”;
20. Të revokojë aktin administrativ nr. 34, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Shëndetësie”;
21. Të revokojë aktin administrativ nr. 10 datë 01.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;

22. Të revokojë aktin administrativ nr. 6, datë 14.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike PAK*”.
5. Njësia përgjegjëse, të miratojë planin vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2016 sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil*”, si dhe ta publikojë atë në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.
6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.
7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:
- a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimin dhe vlerësimit (*Komiteti i Përherëshëm i Pranimin për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- b) Të bëjë publike në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:
- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimin (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së

kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*” ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Përmet, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

9. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Përmet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA